



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/A43-9 Prot.
Nr. Dok. 202502805/9

Tiranë 17/12/2025

Lënda : Rekomandim për marrjen e masave për vijimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen e subjektit "I" kundër Shqipërisë.

Drejtuar : Sekretarit të Përgjithshëm
Pranë: Këshillit të Ministarve

TIRANË

Avokaturës së Shtetit

TIRANË

Për dijeni: Subjektit "I"

TIRANË

I nderuar z. Kryeministër!
I nderuar z. Avokat i Shtetit!

Institucioni i Avokatit të Popullit (në vijim AP), në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për **mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit**, si dhe në funksion të **garantimit të tyre**, në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ka administruar ankesën e subjektit "I" Në ankesë, prezantohet çështja e shkeljes/cenimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të veprimtarisë administrative për ekzekutimin e vendimit datë 05.03.2024, të dhënë prej Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), për çështjen "*Çështja "I". kundër Shqipërisë*", sipas të cilit është vendosur:

“4. Vendos:

a) që shteti i paditur t’i paguajë shoqërisë kërkuese, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme:

i. 4800 Eura për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet;

ii. 6000 Euro për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet kërkuetit;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën maxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje”.

Në ankesën drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, subjekti ankues, shprehet, midis të tjerave, se,

“... Me qëllim ezaurimin e interesave të subjektit tonë, më datë 19.07.2024, kemi dërguar një kërkesë për fillimin e ekzekutimit të vendimit të lartpërmendur. Kërkesa në fjalë i është dërguar Këshillit të Ministrave, për dijeni Avokaturës së Shtetit dhe Ministrisë së Financave. Ajo ishte e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm. ...

Pas pothuajse një muaji (datë 14.08.2024), Zyra e Bashkëqeverisjes na dërgon një e-mail “Kthim përgjigje”, ku informohemi se Avokatura e Shtetit e ka përmbushur detyrimin e vet sipas ligjit, duke i dërguar kërkesën për ekzekutim Qeverisë Shqiptare me shkresën nr. 1229/4 prot, dhe jemi në pritje të publikimit të VKM-së.

Në pritje të publikimit të VKM-së, e cila do të mundësonte fillimin e ekzekutimit të vendimit, i kemi dërguar përsëri një kërkesë KM-së, më datë 11.04.2025, duke i vënë në dukje se nuk ka respektuar afatet e parashikuara prej ligjit dhe se, në mënyrë arbitrare po përpiqet të zvarrisin procesin, që vendos atë pak drejtësi për klientin tonë.

Ka kaluar më shumë se 1 muaj dhe Qeveria Shqiptare ka zgjedhur të heshtë ndaj kërkesave dhe pretendimeve tona, duke mos kthyer as përgjigje, por edhe duke mos publikuar VKM-në me qëllim ekzekutimin e vendimit datë 05.03.2024, të GJEDNJ-së.

... Përkthimi zyrtar është publikuar më datë 03.06.2024, kështu që Avokatura e Shtetit duhet t’i ishte drejtuar Këshillit të Ministrave me kërkesë deri më datë 08.06.2024. Këshilli i Ministrave duhet të kishte marrë një vendim brenda datës 08.07.2024. Kjo nuk ka ndodhur edhe pse afati tre mujor që ky vendim të konsiderohej përfundimtar ka mbaruar që më datë 05.06.2024.

... VKM-ja për ekzekutimin nuk është miratuar ende (në Fletoren Zyrtare janë botuar vetëm dy vendime të kësaj natyre përgjatë 2024¹) edhe pse afati i fundit për ekzekutimin e saj ishte data 05.09.2024, sipas nenit 19/4 të ligjit.

Ka kaluar pothuajse 1 vit nga data që vendimi i GJEDNJ-së ka marrë formë përfundimtare dhe është bërë i ekzekutueshëm, si dhe 9 muaj nga dita që KM duhet të kishte publikuar VKM-në, në kuadër të përmbylljes së procedurave, ndërkohë që ne nuk kemi asnjë përgjigje tjetër përveçse mesazhit të përcjellë me anë të e-mail-it, më 14 gusht”.

Përsa pretenduar prej ankuesit, pranimi për shqyrtim i çështjes është kryer në kushtet e dyshimit për shkeljen e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mospërfundimit të procedurave për ekzekutimin e vendimit datë 05.03.2024, të dhënë prej GJEDNJ-së, në afatin ligjor të procedimit administrativ.

Në këto kushte, bazuar në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe parashikimin e nenit 19, pika “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, sipas të cilit: “Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, institucioni ynë me anë të shkresës nr. K3/A43-2 prot., datë 03.06.2025, ka kërkuar juve z. Sekretarit të Përgjithshëm, informacion dhe shpjegime, lidhur me:

- veprimtarinë e mundshme të kryer për ekzekutimin e detyrimit në të holla, sikurse vendosur prej GJEDNJ-së me vendimin datë 05.03.2024, për çështjen e subjektit, “I” kundër Shqipërisë”;
- Prezantimin e shkaqeve që mund të justifikojnë mosekzekutimin deri më sot të vendimit të dhënë prej GJEDNJ-së për çështjen e subjektit “I” kundër Shqipërisë”;
- Vënien në dispozicion të kopjes së dokumentacionit të mundshëm (akte, shkresa, ekstrakte, etj) të mbajtura në veprimtarinë për ekzekutimin e vendimit në favor të subjektit “I” kundër Shqipërisë”, si dhe çdo informacioni tjetër që ka lidhje me çështjen e paraqitur.

Në përgjigje të kërkesës, Sekretari i Përgjithshëm, pranë KM-së me shkresat nr. 2823/1 prot, datë 27.06.2025 dhe nr. 2823/3 prot, datë 23.07.2025, bën me dije,

¹ VKM nr. 177, datë 27.03.2024, “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 07.11.2023, për çështjen “D dhe të tjerë kundër Shqipërisë”. publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 54, datë 29.03.2024 dhe VKM-në 658, datë 23.10.2024 “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 07.05.2024, për çështjen “B” kundër Shqipërisë” (për kërkesën nr. 24228/18, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 181, datë 25.10.2024”.

se:

“... informojmë se pranë Kryeministrisë është dërguar nga Avokatura e Shtetit praktika për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 05.03.2024, për çështjen e subjektit “I” kundër Shqipërisë”, ku theksojmë që subjekti “I” është shoqëri italiane e regjistruar në ____.

Projektvendimi “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, për çështjen e subjektit “I” kundër Shqipërisë” është vlerësuar të mos i nënshtrohet procedurave të miratimit në kuadër të masave që janë marrë për të mos miratuar një kategori të caktuar aktesh që mund të binin ndesh me kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator të KQZ”.

Projektvendimi “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, për çështjen e subjektit “I” kundër Shqipërisë”, rezulton deri më sot i pamiratuar, edhe pse afati i parashikuar në legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e detyrimit të vendosur është tejkaluar.

Avokatura e Shtetit, në përgjigje të kërkesës së Institucionit tonë, me shkresën nr, 3566/1 prot, datë 22.07.2025, bën me dije, midis të tjerave, se:

“Avokatura e Shtetit ... pasi ka marrë masat për përkthimin e vendimit dhe botimin e tij në fletoren zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, ka vijuar procedurat e ekzekutimit, duke përcjellë kërkesën nr. 1229/4 prot, datë 05.04.2024, “Lidhur me ekzekutimin e masave individuale dhe ekzekutimin financiar të vendimit datë 05.03.2024, të GJEDNJ-së “I” kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 31011/09.

Sa më sipër, procedurat janë iniciuar nga Avokatura e Shtetit pranë organeve kompetente dhe mbetemi në pritje të miratimit të VKM-së përkatëse për ekzekutim. ... Avokatura e Shtetit e ka informuar kërkuuesin në lidhje me procedurat e ndjekura të ekzekutimit nëpërmjet bashkëqeverisjes, ku i ka dhënë të gjithë informacionin që po ua parashtron edhe juve”.

Institucioni ynë, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga përfaqësuesit e subjektit “I”, si dhe përgjigjet zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm pranë Këshilli i Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së për çështjen e sipërpërmendur, në zbatim të kompetencave të parashikuara në:

- **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (RSH)²;**

² Neni 122. “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

- Ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar;
- Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), veçanërisht nenin 1 dhe 46³,
- Legjislacionin shqiptar që rregullon procedurën e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së⁴.

konstaton se janë plotësuar kushtet për dhënien e këtij rekomandimi.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut përveç garancive për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, përmban edhe mekanizmin i cili ka për qëllim të sigurojë një realizim efektiv nga shtetet si palë kontraktuese të kësaj marrëveshje ndërkombëtare. Prej këtej, një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm ka GJEDNJ-ja e cila në vendimet e saj analizon dhe konstaton nëse shteti ka shkelur ndonjë dispozitë konkrete të Konventës. Me qëllim që vendimet, dhe rrjedhimisht me këtë edhe të drejtat e mbrojtura me Konventën, të mos jenë thjeshtë vetëm një e drejtë e fituar në letër, vetë Konventa në mënyrë eksplicite parashikon forcën detyruese të vendimeve për shtetet, si dhe kompetencën për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e tyre. Në këtë kuptim, një rëndësi të veçantë ka neni 46 i KEDNJ-së.

Nga përmbajtja e nenit 46, paragrafi 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shihet se vendimet e GJEDNJ-së kanë forcë detyruese, që nënkupton se shtetet duhet të ndërmarrin detyrime që t’i respektojnë vendimet përfundimtare dhe ato të formës së prerë të Gjykatës. Neni 46 zbatohet për çdo vendim në të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës, e që i’a imponon shtetit përgjegjësinë detyrimin juridik t’i japë fund shkeljes dhe të sigurojë dëmshpërblim për pasojat e tij⁵.

Detyrimi për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, konstatohet i mirëpërcaktuar në nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Sanksionimi i kryer në këtë dispozitë krijon një sistem ku:

- **KEDNJ është pjesë e brendshme e të drejtës shqiptare;**

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendimit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj”.

³ Neni 1. “Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut Palët e Larta Kontraktuese i njohin çdo njeriu që ndodhet nën juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin i të kësaj Konvente”

Neni 46. “Fuqia detyruese dhe zbatimi i vendimeve

1. Palët e Larta Kontraktuese zotohen t’iu binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ato janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyrë zbatimin e tij”,

ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

⁴ Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

⁵ Papamichalopoulos dhe të tjerë kundër Greqisë (Article 50), 31 October 1995, § 34, Series A no. 330-B

- vendimet e GJEDNJ-së kanë efekt të detyrueshëm;
- asnjë ligj, akt nënligjor apo rrethanë e brendshme nuk mund të justifikojë moszbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së;
- procedurat e brendshme (si VKM-ja e ekzekutimit) duhet të shërbejnë vetëm për kryerjen teknike të detyrimit, dhe jo për ta bllokuar atë.

Në rastin e Shoqërisë “Iliria” S.R.L, mospërmbushja e detyrimit nga Këshilli i Ministrave vlerësohet se nuk vjen në përputhje me parimin e epërsisë të së drejtës ndërkombëtare, sipas nenit 122, paragrafët, 1, 2, dhe 3 të Kushtetutës. Përmendja si shkak në shkresën nr. 2823/1 prot, datë 27.06.2025, drejtuar Avokatit të Popullit, se, mosmiratimi i projekt vendimit të dërguar prej Avokaturës së Shtetit: *“... bie ndesh me kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ”*, nuk përbën arsye që mund të justifikojë mosekzekutimin e vendimit datë 05.03.2024, të GJEDNJ-së për çështjen e subjektit *“I” S.R.L. kundër Shqipërisë*. Në kushtet e ratifikimit të KEDNJ-së (marrëveshjes ndërkombëtare) me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, *“Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*, prej Kuvendit të RSH, si dhe, në kuptim dhe zbatim të paragrafit 2, të nenit 122 të Kushtetutës së RSH-së, ngritja e pretendimit të sipërcituar për mosekzekutimin e vendimit në fjalë të GJEDNJ-së, nuk qëndron. Pra, arsyeja e dhënë nga KM, se miratimi i VKM-së për ekzekutimin e vendimit datë 05.03.2024, të GJEDNJ-së, mund të bjerë ndesh me kategorinë e akteve të ndaluara për t’u nxjerrë gjatë periudhës zgjedhore, në kuptim të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator të KQZ-së, nuk gjen mbështetje të plotë ligjore. Pika 2 e nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon në mënyrë të qartë epërsinë në zbatim të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, edhe nëse ajo nuk pajtohet me ligjin e brendshëm të vendit, të përmedur në shkresën drejtuar Avokatit të Popullit.

Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka një parim **absolut dhe të përsëritur**: ***“Asnjë shtet palë nuk mund të justifikojë moszbatimin e një vendimi përfundimtar të GJEDNJ-së duke u mbështetur në papajtueshmërinë me ligjin e vet të brendshëm”***⁶.

⁶ Burdov (Nr. 2) kundër Rusisë, nr. 33509/04, § 70: *“Shteti nuk mund të justifikojë moszbatimin e detyrimeve të tij me vështirësi financiare apo pengesa procedurale të natyrës së brendshme.”* Gjykata nënvizoi se: *“detyrimet që rrjedhin nga neni 46 janë të menjëhershme, dhe se, pengesat e brendshme, përfshirë kufizime buxhetore ose ligjore, nuk kanë asnjë vlerë justifikuese”*.

Hornsby kundër Greqisë, nr. 18357/91, § 41: *“Shteti nuk mund të përdorë si argument mungesën apo*

Në përmbledhje të standardit të konsoliduar të GJEDNJ-së, kuptohet se, kjo Gjykatë ka qenë e qartë dhe ka një jurisprudencë të konsoliduar, lidhur me qëndrimin e shteteve për pamundësinë e përdorimit të ligjit të tyre të brendshëm si justifikim për moszbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së.

Pra, në rastin e subjektit *“I” kundër Shqipërisë*, arsyetimi i Këshillit të Ministrave, se VKM-ja nuk mund të miratohet për shkak të kufizimeve të Kodit Zgjedhor bie ndesh me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenin 46 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Në dritën e jurisprudencës së përmendur, argumenti i dhënë për rastin në fjalë nuk është i lejueshëm sipas standardeve të GJEDNJ-së, dhe mospërputhshmëria e pretenduar me ligjin e brendshëm nuk përbën arsye ligjore për moszbatim. Vonesa e krijuar cenon të drejtën e kërkuarit për ekzekutim efektiv të vendimit brenda afatit tre-mujor⁷, dhe se, shteti mban përgjegjësi të plotë për pasojat financiare dhe juridike të vonesës.

Procedura e ekzekutimit të vendimit datë 05.03.2024, të GJEDNJ-së për çështjen e subjektit, *“I” kundër Shqipërisë*, nuk ka ndjekur në tërësinë e saj parashikimet e ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, *“Për Avokaturën e Shtetit”*, i ndryshuar, pasi nuk ka dal vendimi i Këshillit të Ministrave në përputhje me afatin e parashikuar në këtë ligj. Po ashtu, gjendja nuk ka ndryshuar, ndonëse zgjedhjet në vend janë kryer në datë 11.05.2025.

Kërkesa pranë organit të Kryeministrit rezulton të jetë kryer me kërkesën nr. 1229 prot, datë 05.04.2024, prej Avokaturës së Shtetit, dhe se, deri më sot, nuk është mundësuar miratimi i projektvendimit të dërguar për ekzekutimin e vendimit datë 05.03.2024, të GJEDNJ-së. Konstatohet se kanë kaluar afërsisht 2 vite nga data e marrjes formë të prerë të vendimit në fjalë, dhe se, ekzekutimi i tij, pa shkak, ende nuk është përfunduar.

Afatet janë tejkaluar në mënyrë të pajustificueshme, duke sjellë; shkelje të nenit 46 të KEDNJ-së, cenim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (e drejta e pronës), mungesë të mjetit efektiv (neni 13), si dhe dë financiar të shtuar për shkak të interesave që vijnë të rriten. Po ashtu, vlera e dëmshpërblimit nuk

pamjaftueshmërinë e legjislacionit të brendshëm për të shmangur ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.” Ky është vendimi themelor për parimin: “moszbatimi për shkak të ligjit të brendshëm është shkelje e nenit 6”.

Assanidze kundër Gjeorgjisë [GC], nr. 71503/01, § 173: “Pavarësisht ndarjes së kompetencave të brendshme, shteti mbetet përgjegjës për moszbatimin e vendimeve gjyqësore.”

Jasiūnienė kundër Lituanisë, nr. 41510/19, § 88: “Mangësitë e mekanizmave të brendshëm të ekzekutimit nuk mjaftojnë për të justifikuar vonesën në ekzekutimin e vendimeve.”

⁷ Neni 19/4 i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, *“Për Avokaturën e Shtetit”*, i ndryshuar *“Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse. Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.”*

konsiderohet në vlera të tilla që të ketë vështirësi në përballimin e saj, ndonëse kjo nuk konsiderohet e pranueshme sipas standardeve të GJEDNJ-së.

Nga analiza e dokumentacionit dhe kuadrit ligjor, rezulton se, mosekzekutimi deri më sot i vendimit të GJEDNJ-së ka cenuar gjithashtu parimin e sigurisë juridike, parimin e administratës së mirë dhe veprimin pa vonesa të pajustificuara, parimin e proporcionalitetit administrativ.

Në përfundim, vlerësojmë se mosekzekutimi deri më sot i vendimit të GJEDNJ-së përbën shkelje të qartë të detyrimeve të shtetit shqiptar sipas KEDNJ-së, Kushtetutës dhe legjislacionit të brendshëm. Qëndrimi i shprehur nga ju si autoritet ekzekutive, duke i'u referuar kufizimeve të së drejtës së brendshme, bie ndesh me parimin e epërsisë së detyrimeve ndërkombëtare dhe me standardet e njohura të GJEDNJ-së, duke prodhuar pasoja juridike dhe financiare për shtetin dhe duke cenuar të drejtat e subjektit kërkuar. Për këtë shkak, është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme për garantimin dhe ekzekutimin **efektiv të vendimit përfundimtar** të GJEDNJ-së, si dhe respektimin e të drejtave të subjektit ankues.

Në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së RSH, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Mosveprimi evident në këtë çështje nuk i respekton të drejtat e ligjshme të ankuesit, por përkundrazi, është bërë shkak për shkeljen e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së RSH, ku parashikohet se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”

REKOMANDOJMË

Këshillit të Ministrave:

1. **Të miratojë menjëherë** VKM-në për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së për çështjen e subjektit *“I” kundër Shqipërisë*, pa vonesa të mëtejshme.
2. Të vlerësojë mundësinë për të vendosur një mekanizëm të brendshëm monitories për respektimin e afateve në ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, duke përcaktuar përgjegjësitë administrative në rast vonesash.

Avokaturës së Shtetit:

1. Të ndërmarrë **veprime proaktive** për përshpejtimin e procesit të ekzekutimit dhe të njoftojë zyrtarisht Këshillin e Ministrave për domosdoshmërinë urgjente të miratimit të VKM-së.
2. Të informojë ankuesin/përfaqësuesin ligjor të tij, mbi çdo zhvillim të ri deri në përfundim të ekzekutimit.

Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, në përputhje me parashikimin e nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar, ftohen të njoftojnë/kthejnë përgjigje të argumentuar Avokatit të Popullit, **brenda 30 ditëve** nga marrja e këtij rekomandimi, mbi masat e ndërmarra, kalendarin e ekzekutimit dhe çdo dokumentacioni mbështetës.

Mosmarrja e masave brenda afateve të kërkuara përbën shkelje të detyrimeve kushtetuese dhe ndërkombëtare të shtetit, si dhe sjell pasoja të rënda për subjektin kërkuar dhe shtetin shqiptar.

Institucioni mbetet në monitorim të vazhdueshëm të çështjes deri në ekzekutimin e plotë të vendimit të GJEDNJ-së.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

D.V